



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**NJOFTIM PËR POZICIONIN “INSPEKTOR I LARTË PËR KONTROLLIN E CILËSISË”**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i krijuar në kuadër të Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me seli në rrugën “Ismail Qemali”, Nd. 24, H. 4, Kati 5-të, Ap. 24, Tiranë, kërkon të punësojë një “Inspektor të Lartë për Kontrollin e Cilësisë”.

1. Inspektori i Strukturës Mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike duhet të përmbush kriteret në vijim:
  - a. Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
  - b. Të ketë zotësi për të vepruar;
  - c. Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune të përgjithshme në fushën e auditimit ligjor dhe të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë. Nëse trajnimet konsiderohen të pamjaftueshme ato duhet të kryhen përpara nisjes së Kontrollit të Cilësisë;
  - ç. Të mos ushtrojë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jetë i punësuar apo i angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
  - d. Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore gjatë dy viteve të fundit, kur kjo dispozitë është e aplikueshme;
  - dh. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
  - e. Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

**Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë kandidati:**

- a) Letër motivimi;
- b) Dokument Identifikimi;
- c) Curriculum Vitae;
- d) Fotokopje të noterizuara të diplomave;
- e) Referencë nga punëdhënës të mëparshëm.

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentat e sipërcituara deri në datën 19.05.2022, elektronikisht në adresën e emailit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike ([info@bmp.al](mailto:info@bmp.al)) ose pranë zyrave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike në adresën Rr. Ismail Qemali Nd. 24, H. 4, Kati 5-të, Ap. 24, Tiranë.

Duke ju falënderuar,  
Bordi i Mbikëqyrjes Publike